



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 060/01-23739**

**Pejë, datë: 17 Prill 2026**

**PROCESVERBAL**

Nga takimi i **II-të** i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **17 prill 2026**, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ZKF znj.Hajrije Haxhijaj, Kordinator për Këshilla Lokal, z.Januz Hajzeraj,Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, dhe përfaqësuesit e OSCE-së dhe ZIP-it

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend dite

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite,

## Rendi i Ditës

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.03.2026.
3. Rishqyrtimi i Vendimit Nr.01/2026 – mbi themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF në Komunën e Pejës, në bazë të kërkesës së MAPL për rishqyrtim, me nr. prot: 020-162/5, dt. 13.03.2026.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik të draft Statutit të Komunës së Pejës.
6. Shqyrtimi i progresit dhe adresimi i rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës tre mujore financiare në Komunën e Pejës, për periudhën Janar – Mars 2026.
9. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.
- 10 .Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar:

### **2.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk ka pasur.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.03.2026.**

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent miratohet procesverbali i dt.18.03.2026.

**3.Rishqyrtimi i Vendimit Nr.01/2026 – mbi themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF në Komunën e Pejës, në bazë të kërkesës së MAPL për rishqyrtim, me nr. prot: 020-162/5, dt. 13.03.2026.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: sigurishtë që jeni të informuar që komitet është i obliguar që të përmbaj kriter gjinor. Ne rast të themelimit të Komiteti nuk e kemi arrit me plotësu kuoten gjinore. Si rezultat të shqyrtimit nga MAPL ka ardh një vendim që nuk është në pajtushmëri me dispozita ligjore, kriteri për barazi gjinore. Sot, e kemi sjellë prap në KPF për diskutim sepse edhe në senacë e kaluar kam kërku që nga gjitha partit nese ekziston mundësia me ndru anëtarin për të plotësuar kriterin gjinor.

Z.Bekim Morina: tek kjo çështje ish dasht me reklefktu sepse është obligative. Në senacë të mbajtur për themelimin e Komiteti është kërkuar kuota gjinore nga secila parti. Në këtë rast e vetmja parti AAK-së që nuk ka reflektu i kanë arsyet e veta. Por unë mendoj që nese nuk arrihet ky kontenzus dhe askush nuk don me u terheq, duhet me kërku nga MAPL një zgjidhje se qysh me vepru.

Z.Labinot Panxha: unë mendoj që ne si komunë ose ju si kryesusi i kuvendit me ju referu dispozites së nenit 52.1 ku thotë Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteve politike në kuvendi i komunës dhe nuk e përmend gjinin. Çka po du me thonë unë me këtë nese në listen konkruese kërkohet 30% me u përmbush me gra, nese në kuvend janë zgjedhë më pak se 50 % gra, nese në ekzekutiv janë më pak se 50% gra, atëhere ku e gjejnë obligativen që duhet komitetet ose komisionet me u përbë prej 50% gra? Krejt qka mundem me thën unë se ju duhet me ju drejtu MAPL-së me një shkresë me kundërshtu, dhe me ju thonë që ne e kemi përmbush obligimin tonë. Nese ata e kanë një hapsirë ligjore që na obligon neve me përmbush, atëhere le të na referojnë se si duhet me verpu. Asnjë obligon Aleanca nuk e ka për me përmbush këtë kriter. Kjo është detyrë e kryetarit dhe kryesusit te kuvendit me zgjidhë këtë çështje dhe mos me fajsu asnjë subjek politike. Dhe është në diskrecionin tonë me zgjedhë dhe me propozu kond kemi qejf na në secilin komitet.

Z.Ardit Berisha: ky problem është edhe në disa komuna tjera psh në komunën e Deçanit është e njejta problematik. Andaj nese nuk përmbushet kuota gjinore realisht i takon partisë në pushtet me bo zgjidhjen. Përderisa nga LDK janë 3 anëtar dhe mendoj që në këtë rast partia në pushtet ish dasht me bo një reflektim. Edhe pse ne si VV jemi 50/50 në këtë aspekt por kështu e shoh!

Z.Bekim Morina: në komentin e Arditit ne i kemi 3 prej LDK-së, edhe kryesusi por shkon me automatizem. Paraprakishtë ish dasht me u plotësu kuota gjinore me propozime atëhere kish kalu pa problem. Prap po bjen me permend Aleancë në këtë rast mos të këtë asnjë grua. Kjo është çka po kërkohet ne jemi 2 me 1 dhe kryesuesi shkon me automatizem. Po ashtu jam dakord me Labinotin që tha që të kerkohet nga MAPL se si me vepru me zgjidh këtë problem.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë kisha propozu që këtë pikë mos me dërgu në kuvend deri sa të kemi një kontenzus për ndrimin e anëtarit të kuvendit. Derisa të marim edhe një mendim tjetër prej MAPL-së se si me vepru për zgjidhjen e problemit.

Pas diskutimeve unanimishtë votohet nga gjithë anëtarët prezent, që kjo pikë shtyhet për një seancë tjetër pasi të arrihet një zgjidhje për ndrimin anëtarit.

#### **4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ka ardh një material nga drejtoria e urbanizmit për plotësim/ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës Pejës.

Z.Naim Bytyqi: Hartat Zonale që janë miratu që 3 vjet çka është qëllimi me ndryshu?

Z.Avni Gashi: do të ndryshohen disa gabime teknike. Por si procedurë duhet njëher të meret pëlqimi, të del në diskutim publik, pastaj në seancën tjetër duhet të votohet 2/3 të anëtarëve të kuvendit.

Z.Naim Bytyqi: nese e marim një zonë psh Jarinen dhe teknikishtë kanë gabu dhe e kanë bo B+3 ose 4, tash mos po don me bo qajo B+8? Atëhere e ndron krejt teknika.

Z.Avni Gashi: shkon në diskutim publik, pastaj miratohet në kuvend me 2/3 dhe krejt në fund në ministria e jep pëlqimin a është në rregullë ky ndryshim a jo!

Z.Naim Bytyqi: e kam diskutu edhe atëhere ka banor që kanë prit 10 vite Harten Zonale dhe duke mos investu në shtëpia, për shkak se kanë me u rrëzu e mu ndërto. Edhe ashtu sipas Hartes Zonale u pamundësu ndërtimi e ata kanë investu në shtëpia. Për ata është mirë me ditë!

Z.Ardit Berisha: ne jemi informu me email por material diqka ma shume nuk kemi pa, realisht nuk e kam të qartë se qka ka me ndryshu. Disa gabime teknike i kam pa, ama se kemi te qartë çka do të ndryshohet!

Z.Labinot Panxha: është viti i 5 që kërkoj nga komiteti që asnjë pikë e rendit të dites mos me u votu , pa qenë drejtori prezent që duhet vet me na sqaru dhe me raportu për pikën e rendit dites. Përderisa nuk është prezent këtu drejtoresha me na sqaru dhe me na respektu, propozoj mos me diskutu as me votu.

Z.Bekim Morina: unë pajtohem plotësishtë me Labinotin. Kryesusi dua të kërkoj prej teje që ekzekutivi që ka me raportu për pikën të vet duhet me qenë prezent dhe me na sqaru. Sa i perket kësaj pike të Hartes Zonale, duhet me pas sqarime se qka konkretishtë kërkohet për plotësim/ndryshim.

Znj.Edonjeta Berisha: edhe unë pajtohem që secili drejtor duhet me qenë prezent për me na respektu neve si komitet dhe për me sqaru raportin dhe punën e vet. Nese nuk është i gatshem për debat atëher le të tërhiqet dhe të deklarojë se unë nuk mundem me mar pjesë me juve. Përveq sëmundjes sepse edhe ne vet jemi familjar dhe kemi secili obligime tona. Sepse prezenca është interesi i përgjithëshem dhe nuk është interes individual.

Znj.Valbona Gjakova Taraku: pa dasht me paragjyku sepse nuk e di arsyen e mos prezences së drejtoreshes. Më së pari nuk e di ju kryesus a i keni bo thirrje që me qenë prezent me raportu piken e vet a është në dijeni ajo që kjo pikë ka mu diskutu sot ? Nese ju e keni lajmëru dhe i keni bërë ftesen me qenë e pranishme sot, a të ka kthyer përgjigje, dhe a e ka jep arsyetimin pse po mungon? Sepse nese ajo e ka dit dhe ka jep përgjigje negative, atëherë kjo tregon mungesë seriozitet.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kjo pikë që ka ardh është me inicim të drejtorisë. Drejtorja e ka shumë të qartë që duhet me qenë prezent në takimet e KPF-së, për sqarim për pikat që i propozon. Në material që e keni marrë është e cekme arsyetimi dhe qëllimi i kësaj pike që ka ardh për diskutim në KPF. Po ashtu mungesën e drejtoreshes nuk e arsyetoj aspak, sepse e kanë obligim me qenë pjesë e takimit.

Z.Naim Bytyqi: nuk është temë e lehtë ju kryesus po e shpjegoni mirë pjesën e legjislacionit, mirëpo ne mos të harrojmë që jemi përfaqësues politik. Ne i përfaqësojmë interesat e qytetarëve. Hartat Zonale janë problem shumë i madh për qytetarë. Mospajtimet që i kemi pas na kur është votu, ne u diskriminim para qytetarëve dhe dulem që ne jemi kundër interesave të tyre. Tash po i bjen që na qka kena dasht me ndryshu, po duhet me u ndryshu. Atëherë qysh me votu na?

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 votë kundër, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

#### **5. Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik të draft Statutit të Komunës së Pejës.**(Për shkak të problemeve teknik fillimi i diskutimit të kësaj pike nuk është incizuar).

Z.Labinot Panxha: nese kishin ardh me thonë me nda këtë drejtori ose atë drejtori dhe pjesën tjetër ose me propozu, sepse unë si anëtar i komisionit nuk e di o Ardit a ju kanë marrë këtyre kompetencat a jo!

Znj.Edonjeta Berisha: edhe unë jam anëtare e komisionit sa i perket takimit që e kena mbajt me kryesusin e komisionit dr.Islamin. Kur kemi kërku që dr.Islami me na sjellë materialin ka thonë që materialine bëjmë na dhe ne nuk kemi qenë dakord sepse nuk mundemi na me kërku me nda një drejtori sepse nuk j'a dim specifikat. Si psh me nda Kulturë dhe Sport ne nuk dim se qka ka me kalu në sport dhe qka në kulturë. Nese ai kish thonë që materiali është i gatshëm prej ekzekutivit na sot e kalojmë piken. Nese Drafti që vjen prej ekspertit ka me u prezentu prej ekspertit ose prej kryetarit jo prej komisionit dhe jo prej dr.Islamit, unë nuk jam dakord që kjo pikë me kalu pa pas na diqka material dhe nuk muj me thonë po kur nuk di qka kemi bo aty!

Z.Bekim Morina: rolin e komisionit besoj e keni lëxur në vendim. Ju jeni ata që keni me ju rekomandu kuvendit Draf-Statutin. Nuk mundeni me bo qata sespe ju duhet vite me punu me shqyrtu secilin material që ka komuna dhe problemet që kanë me harmonizu. Ju keni me pa se cilat janë të arsyshme dhe cilat nuk janë, pastaj kuvendi e dergon në diskutim publik. Në momentin që vjen në kuvend mandati juaj ka përfunduar.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ne na ka ardh si material dhe ju e dini që komiteti nuk i kthen pikat. Në këtë rast unë nuk muj me kthi se me ka ardh si propozim i ekzekutivit, nese ju si komision që jeni përcaktu nese nuk vjen materiali me kohë nuk e qesim në shqyrtim si pikë të rendit dites.

Z.Avni Gashi: vetem një sqarim edhe unë si anëtar i komisionit Statuti është 70 ose 80% çështje e ekzekutivit, funksionimit të administrates dhe kuvendit. Normal që ekzekutivi i ka anëtarët e vet qysh i ka propozu. Dhe një draft prej ekzekutivit vjen dhe besoj të hanen kemi me pas ne si anëtar të komisionit. Ky është propozimi fillestar që komisioni me ekspertizën e vet shton ose heq qka është e nevojshme. Atë ditë në komision ka shku gjithqka sipas rendit dites, përveq ndryshimit që e ka bo Arditi dhe Labi në disa çështje! Nuk ka vendos komisioni që mos me ardh në KPF kjo pikë. Të hënen komisioni ka me pas një draft fillestar prej ekzekutivit dhe gjithmonë nga ekzekutivi dhe nuk ka palë të tretë.

Z.Labinot Panxha: Avni, je duke fol në emër të komisionit. Nese kishte me qenë kshtu ja kishim jep fjalën Islamit dhe ai me qenë ktu për këtë pikë. Veç ti nuk je dakordu, se na tonë kemi qenë dakord që kjo pikë mos mu diskutu sepse nuk kemi material. Më e rëndësishmja ktu në këtë pikë si anëtar të komisionit a kemi material, a kemi draft me j'a rekomandu kuvendit? Jo, nuk e kemi asnjeren. Nese ju doni me rekomandu kete pikë qeshtu ok , ju i keni votat siç tha edhe Naimi.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nese të hënen nuk ju vjen materiali, e terheqim këtë pikë nga rendi i dites.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 4 votë pro, 5 kundër, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

## **6. Shqyrtimi i progresit dhe adresimi i rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e keni marrë një material paraprakishtë është adresimi i rekomandimeve të auditorit. Sipas këtyre rekoamndimeve janë hapat që kanë marrë drejtorit dhe ekzekutivi.

Znj.Valbona Gjakova Taraku: adresimi i rekomandimeve të përgjithëshme sipas planit të veprimit te një pikë B8 - Dobësi në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit. Ky rekoamndim nuk është zbatu deri me tani regjistrimi i kontratave në sistemin elektronik E-Kosova. Kjo nuk është vetem çështje teknike por tregon mungese të menaxhimit dhe përgjegjësis. Këtu kanë jep një arsytim se është ngarkesë pune. Mirëpo ky arsytim nuk qendron sespe tregon mungesë të planifikimit. Pa arkivim elektronik të kontratave nuk sigurohet edhe rezikohet transparencja dhe kontrolli i parasë publike. A e ka bë komuna një analizë të kapacitetit të stafit? Apo një menaxher sa kontrata i menaxhon mesatarisht? A mos janë menaxherat e kontratave shumë të ngarkua që spo mundën me bo regjistrimin e kontratave në platformen elektronike.

Znj.Hajrije Haxhijaj: po kjo është e gjetur. Menaxherat e kontratave janë të obliguar që çdo pagesë që bëhet me fut në sistemin elektronik. Duke marrë parasysh tek projektet kapitale ka shumë pak menaxhera të kontratave dhe kjo është pak ngarkesë duke marrë parasysh që

shumicen e kohës janë në përcjellje të punëve. Ne e kemi diskutu këtë pikë, po ashtu dhe i kemi trajnu disa zyrtarë që e përcjellin. Po ashtu edhe ka disa menaxher të kontratave që gjitha pagesat i fusin në sistem, por është një numër shumë i vogël. Por shpresojmë që këtë vit kemi me pas zbatim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 3 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: pasi që nuk është drejtori prezent, e hapim diskutimin në bazë të listës dhe materialit që keni marrë!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 3 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës tre mujore financiare në Komunën e Pejës, për periudhën Janar – Mars 2026.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e keni materialin për këtë informatë tre mujore edhe ZKF-në e keni prezent për sqarim shtesë.

Znj.Hajrije Haxhijaj: sa i përket raportit kemi rritje të realizimit të të hyrave vetanke. Tek tatimi në pronë është pak më i ultë, duke marrë parasysh që nuk janë lëshu faturat me ngarkesë vjetore të vitit aktual. Në muajin prill vetem ka fillu pagesa e tatimit në pronë dhe kemi rritje të hyrave. Tek shpenzimet pagat hyn në realizim duke marrë parasyshë sa është paga e 13-të. Në muajin mars janë përfshi gjitha ndryshimet që kanë qenë muajin janar dhe shkurt janë ekzekutuar në muajin mars. Duke përfshi edhe përvojën e punës që ka qenë me diferencën 0.25 për muajin janar dhe shkurt.

Znj.Valbona Gjakova Tarku: sa i përket kesaj pasqyre tre mujore financiare është e vërtetë që është një kohë shumë e shkurt, por megjithëate kërkon raport dhe analizë. Tek pasqyra e vërejta që ka shfaqje të shpeshtë të gabimit teknik si quhet divi0. Kjo nuk e besoj që është vetem çështje teknike i exel-it, i cili tregon mungesë të dhënave dhe seriozitetit në raportim. Në realizim të hyrave kemi një përqindje më të vogël në krahasim me periudhën e njejt të vitit paraprak me 8.81% rrënje tek të hyrave. Nese vazhdon kështu është rrezik me u realizu plani vjetor i cili pastaj rrezikon në realizim të investimeve të kapitale. Gjithashtu në raport po mungojnë edhe të dhënat e gjobave komunale, a mundemi me dit arsyen pse nuk janë paraqit gjobat komunale në raport?

Znj.Hajrije Haxhijaj:gjobat komunale menxhohen direkt nga ministra e punëve të brendshme. Ato janë të hyra indirekte të cilat i sjellin komunes çdo tre muaj. Ne gjobat për trafik kur duhet

me bo raportimin nuk i kemi të evidentuara prej ministrisë. Gjohat në trafik na kanë ardh dje dhe unë i kam të prezentuara, dhe në seancën e radhes do ta dergojmë raportin me përmisim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 3 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

## **9. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e kemi një material që ju ka ardh mbi funksionimin e këshillave lokal të komunës së Pejës. Kordinatorin z.Januzin e kemi prezent për sqarim shtesë.

Z.Januz Hajziraj: unë i kam përmbledhë në një tabelë të gjitha të dhënat. Ka edhe kryetar të këshillave lokal që i kanë mbajtur 32 takime gjatë gjithë vitit për Kadri Mavraj- Këshilli Lokal 7 Shtatori. Por si kam përmbledh të gjitha sepse obligative i kanë vetëm 6 takime. I kam përmbledh të gjitha edhe kërkesat që janë drejtuar komunës dhe drejtorive në përgjithësi. Kemi kërkesa të ndryshme të qytetarëve për asfaltimin e rrugëve, ndriqimin, për kanalet e ujtjeve, kanalizimin etj. I kemi të gjitha procesverbalet e të gjitha këshillave lokale.

Z.Bekim Morina: Sa i përket kryetarëve të këshillave lokale të gjithë e meritojnë një falenderim sepse janë duke e bërë një punë të madhe. Unë mendoj që një pjesë e punës tyre po reflektohet në projektet që në vazhdimësi po hyn në buxhet dhe po buxhetohen.

Znj.Valbona Gjakova Taraku: tek ky raport secili paragraf fjalitë e njejta. Unë nuk mendoj që secila pjesë e qytetit të Pejës i ka problemet e njejta. Pse ka ndodhë kjo? Të gjitha paragrafet janë të njejta me pikë e presje.

Z.Januz Hajzerja: tek specifikat e para e kam bërë një përshkrim në bazë të kërkesave që ata i kanë bërë! Tek këshilli lokal në Bogë ka specifik rrugën kryesore, unë i kam përmbledhur për afërsisht nga të gjitha kërkesat e takimeve që ata i kanë në procesverbal. Unë jam kordinator edhe i disa pozicioneve tjera dhe nuk mundem për secilin procesverbal me shkruar, ato janë të rruajtura të gjitha në foldera.

Z.Ardit Berisha: Valbona plotësisht ka shumë të drejtë, nuk është arsytim i kordinatorit por me thonë skom pas kohe me bo raportin qysh duhet, edhe pse respekt për punën që e bën dhe

angazhimin ., Në Kryshhec psh nuk i ki cekë kërkesat e kryetarit bashkësisë lokale, ish dasht me i cekë së paku tri kerkesa nga secila bashkësi lokale mi përfshi në raporti ish dal me serioz.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Kërkesat më të shumta janë për ndriqim, infrastrukturë, kanalizim etj. Sa i përket këshillave lokale funksionojnë shumë mirë dhe shumë kërkesave të tyre janë realizuar.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 3 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

**10. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar:**

Z.Ardit Berisha: sa i perket pyetjeve me shkrim dy prej tyre Avnia mi ka përcjellë, por janë janë edhe 3 prej tyre!

Z.Avni Gashi: si e marr përgjigjen, unë ju përcjelli juve!

Kryesusi rexhep Kurtbogaj: një sqarim sa i perket mos prezencesë së drejtorave. Unë nuk jam i obliguar as me i mbrojtë drejtorat, kur ata nuk e shohin të arsyshme me qenë prezent në takim që është me rëndësi.

*Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:20 h.**

**Procesmbajtësja,  
znj. Donjeta Morina**





THE UNIVERSITY OF CHICAGO  
DEPARTMENT OF CHEMISTRY  
5800 S. UNIVERSITY AVENUE  
CHICAGO, ILLINOIS 60637

TO: THE DIRECTOR, NATIONAL BUREAU OF STANDARDS  
4300 RESISTANCE AVENUE  
GAITHERSBURG, MARYLAND 20899

FROM: DR. J. H. GOLDSTEIN  
DEPARTMENT OF CHEMISTRY  
UNIVERSITY OF CHICAGO  
5800 S. UNIVERSITY AVENUE  
CHICAGO, ILLINOIS 60637

RE: 13C NMR SPECTROSCOPY OF POLYMERIZATION PRODUCTS

Enclosed for the Bureau are two copies of a report on the  
13C NMR spectroscopy of polymerization products. The report  
contains a summary of the work done in this area at the  
University of Chicago and a list of references.



Very truly yours,  
J. H. Goldstein